



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:194016

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05539742

Ac.nr.2957/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimgaj kryetar i kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. G. (Gj.) nga fshati B., Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson me autorizim E. P. avokat në Viti, kundër të paditurit A. T. (S.) nga B., Komuna e Vitisë, me objekt të kontestit për pengim të posedimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.853/2022 i datës 05.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit I. G. (Gj.) nga fshati B., Komuna e Vitisë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.853/2022 i datës 05.04.2023, VERTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, C.nr.853/2022 i datës 05.04.2023, ka vendosur: I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit I. G. (Gj.) nga fshati B., Komuna e Vitisë, me pretendimin se i padituri A. T. (S.) nga B., me ndërtimin e bazamentit apo pllakës së betonit prej m² në ngastrën kadastrale nr.....-0, ZK Kabash, në pronësi të pasurisë shoqërore “U.....”, e ka penguar paditësin, në qasje në pasurinë së tij, duke ia pamundësuar hyrje daljen në pronën e tij – në ngastrën nr.....-2 ZK B.. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktvendimi paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që aktvendimin e atakuar ta anulojë dhe lëndën ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit edhe pse i njëjti me kohë e ka pranuar ankesën e paditësit.

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi I. G. (Gj.) nga fshati B., Komuna e Vitisë, më datë 21.09.2022, ka paraqitur padi për pengim posedimi kundër të paditurit A.T.(S.) nga B., Komuna e Vitisë, me kërkesë të parashtruar si në padinë e paditësit të parashtruar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesor, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktvendimin e ankimuar C.nr.853/2022 i datës 05,04,2023, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesë padinë e paditësit duke vendosur konkretisht si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se: Gjykata vlerëson se vrojtimi i drejtpërdrejt i vendit të ngjarjes në prani të ekspertit gjeodet ishte provë dominuese në raport me provat e tjera nga edhe buron ekspertiza kadastrale. Bindjen e gjykatës se i padituri nuk e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e qetë të sipërfaqes prej 100 m², nga ngastra nr.-2, e forcon deklarata e vetë përfaqësuesit të paditësit, me rastin e deklarimit të tij në seancën kryesore, i cili në pyetjen e gjykatës, ka deklaruar se paditësi pjesën e ngastrës kontestuese, ku është nisur së ndërtuari bazamenti nuk e kishte pasur asnjëherë në posedim.

Më tej ka shtuar se: Po ashtu, përfaqësuesi i paditësit në seancën kryesore gjatë përgjigjes së pyetjeve të gjykatës, ka thënë se paditësi nuk ka pasur qasje deri në pronën e tij (ku e ka të ndërtuar shtëpinë në ngastrën nr.....-2), përmes pjesës-sipërfaqes nga ngastra-0, ku ka filluar ngritja e përmendores, sepse ka hyrë nga hyrja e oborrit të vëllait të tij, nga ngastra-1 ZK B., ndërsa tani pasi e kanë shkëputur bashkësinë familjare, andaj e vetmja mundësi për të hy në oborrin e tij i mbetet të hyjë nga ngastra nr.....-0 dhe nga një pjesë e ngastrës nr.....-0. Deklarata e përfaqësuesit të paditësit ishte në kundërshtim me pretendimet e paraqitura në padi dhe kërkesëpadi, sepse i njëjti gjatë shqyrtimi gjyqësor kishte pranuar se ngastra kontestuese asnjëherë nuk ishte në pushtetin faktik dhe në shfrytëzim të paditësit, por vetëm që e njëjta është vendosur prapa oborrit të tij, me çka i pengon të njëjtit në qasjen eventuale në oborrin e tij.

Më tej ka shtuar se: Nga vendi i ngjarjes gjykata nuk ka vërejtur askund të jetë hapur fizikisht ndonjë derë apo çfarëdo hyrje në pronën e paditësit nr.....-2, nga ngastra-0, apo nga ajo nr.1.....-0, por prona e tij ishte e rrethuar me muri, aty ku nuk e mbulonte plemja e paditësit (shih fotografinë e vendit të ngjarjes e bashkangjitur me ekspertizë).

Më tej ka arsyetuar se: Bazuar në provat e lexuara, shikimi i drejtpërdrejt i vendngjarjes, duke mos e përfshirë edhe deklaratën e përfaqësuesit të paditësit të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor, konstatohet se i padituri nuk e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e pronës së vetë në ngastrën nr.....6-2, se paditësi asnjëherë nuk e ka pasur dhe nuk e kanë posedim edhe tani pjesën e pronës ku ka filluar ngritja e përmendores, por konstatimi i gjykatës është që paditësi dëshiron të siguroj që në të ardhmen të ketë qasje në pronën publike edhe në anën veriore të ngastrës së tij nr.....-2, sikur që tani e ka qasjen në anën lindore, respektivisht nga rruga publike “I. D. K.”.

Më tej ka shtuar se: Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në konstatimet dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit, se i njëjti asnjëherë nuk ka qene ne posedim dhe as në pushtetin faktik të ngastrës kadastrale ku është i ndërtuar bazamenti me material të fortë dhe ne këtë mënyrë nuk janë përmbushur ne mënyrë kumulative dy kushtet kryesore te pengim posedimit, siç janë që sendi të jetë në pushtetin faktik të paditësit si dhe i njëjti të jetë i penguar në mënyrë të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtës së vet- posedimit. Ky konstatim u vërtetua në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e të pa anshëm nga gjykata, gjithnjë duke u bazuar në provat materiale të cilat u vlerësuan, por edhe deklarata e përfaqësuesit te paditësit, e bënë gjykatën që ta nxjerr konkludimin e sigurt juridik, se i padituri nuk e ka penguar paditësin me ndërtimin e bazamentit ne ngastrën kadastrale nr.1452-0 ZK Kabash, sepse nuk ishte në pushtetin faktik të tij, por kjo ngastër përfshirë edhe sipërfaqen kontestuese është në pronësi publike. Gjykata në këtë rast, ka vendosur drejtë duke trajtuar dhe vërtetuar vetëm faktin e ushtrimit të pushtetit faktik në sipërfaqen e ngastrës kontestuese.

Më tej ka shtuar se: Me nenin 111.1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Ligji Nr.03/L-154 shprehimisht thuhet: *“Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohet shprehimisht me ligj”*. Andaj, Gjykata e bindur se paditësi nuk e kishte pushtetin faktik në sipërfaqet kontestuese edhe para, por edhe në momentin e pengimit të tij nga i padituri, e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit.

Lidhur me mënyrën e vendosjes është bazuar në kuptim të nenit 142, paragrafi 3 dhe nenit 480 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës është vendosur në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësit se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n) të LPK-së, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është i qartë i kuptueshëm dhe nuk është kundërthënës me arsyet e tij. Po ashtu aktvendimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, janë dhënë arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka gjetur se i paditurit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të pengimit të posedimit të paditësit në paluajtshmërinë e tij me nr.-2 ZK B..., pasi që edhe gjykatës së Apelit i rezulton e njëjta gjendje faktike e vërtetuar. Me të drejtë është vërtetuar se i padituri në cilësinë e kryetarit të fshatit, me autorizimin e të gjithë komunitetit, ka ndërmarrë veprime në ndërtimin e pllakës përkujtimore në ngastrën kadastrale-0 ZK B..., e cila ngastër kadastrale evidentohet në emër PSH. “U....e” dhe se paditësi asnjëherë nuk ka qenë në posedim të kësaj parcele dhe se ndërtimi i kësaj pllake nuk e pengon paditësin në shfrytëzimin e qetë dhe të lirë të paluajtshmërisë së tij, pasi që i njëjti edhe para ndërtimit të kësaj pllake, paluajtshmërinë me nr.-0 ZK B..., në të cilën ka filluar të ndërtohet pllaka prej betoni nuk e ka shfrytëzuar asnjëherë kjo për faktin se në mes dy parcelave, parcelës me nr....-2 ZK B...ë, e cila evidentohet në emër të paditësit dhe parcela-0 ZK B....., që evidentohet si pronë shoqërore, në të cilën ka filluar ndërtimi i pllakës, gjendet lumi dhe se paditësi nuk ka mundur ta shfrytëzojë këtë pjesë për hyrje në shtëpinë e tij, fakte këto të vërtetuara nga provat që janë administruar në këtë çështje kontestimore e sidomos ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë e punuar nga eksperti T... N. e datës 15.02.2023, i cili në mënyrë grafike dhe shume të kjart ka paraqitur gjendjen faktike në teren nga ku shihet se pllaka e ndërtuar nga komuniteti i atij vendi nuk i pengon fare paditësit në shfrytëzimin e paluajtshmërisë së tij. Andaj, nisur nga kjo gjendje e vërtetuar, gjykata e Apelit konstaton se i padituri me asnjë veprim nuk e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e qetë dhe të lirë të paluajtshmërisë së tij dhe se një pretendim i tillë nga ana paditësit është i pa bazë dhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale pasi që sipas nenit 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përrjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përrjashtohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.”*. Nga vetë koncepti ligjor i mbrojtjes së posedimit, rrjedh detyrimi i gjykatës që e njëjta të provojë vetëm posedimin e fundit dhe atë pa u lëshuar në rrethana që lidhen me bazën juridike. Andaj, në rastin konkret nuk është kontestuese se paditësi është pronarë i ngastrës P-

.....-2 ZK B..., për të cilën pretendon se është penguar në shfrytëzimin e sajë, mirëpo veprimet e të paditurit të ndërmarra në parcelën me nr.-0 ZK B..., e evidentuar si Pronë Shoqërore nuk paraqesin pengim të posedimit, pasi që paditësi me asnjë provë nuk ka vërtetuar se i njëjti është posedues i pjesës së pretenduar në pengim të posedimit. Sipas nenit 7 par. 1 të LPK-së, i cili parasheh që “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Andaj, në rastin konkret paditësi ka dështuar të paraqes prova për të vërtetuar faktet e parashtruara në padi.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me atë se i padituri pllakën e ndërtuar e ka nisur në ndërtim pa leje adekuate dhe se të njëjtit i janë ndalë punimet, por të njëjtat pretendime nuk janë marrë për bazë pasi që në këtë çështje kontestimore nuk ka rendësi fare se i padituri a kishte apo jo leje ndërtimi, e rëndësishme ka qenë se me veprimet e të paditurit, paditësi nuk është penguar në posedimin e lirë dhe të qetë të paluajtshmërisë së tij dhe ky posedim nuk varet nga leja e ndërtimit të të paditurit, kjo për faktin se veprimet e të paditurit mund të paraqiten si pengim posedim i paditësit në pronën e tij apo edhe në parcelën ku ka filluar ndërtimi i pllakës, gjë që në rastin konkret nuk kishte kurrfarë pengimi të posedimit.

Janë vlerësuar edhe pretendime tjera ankimore të paditësit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të njëjtat pretendime nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe në ankesën e paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, gjykata e shkallë së parë e ka marrë në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në dispozitat ligjore përkatësisht nenin 450 të LPK-së, pasi që i padituri nuk i kishte kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga të cekurat më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 194, 209 parag.1 pika b) të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2975/2023 me datë 03.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v